



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 144, Datë 28.05.2026

MBI

**MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 13 dhe 15 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1099/5 prot., datë 26.05.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “SPV Blue 2” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 296 datë 30.12.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga parku fotovoltaik “Blue 2”, me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar, i ndryshuar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1099 prot., datë 08.04.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e Aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 50 MW.
- Me Vendimin të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 183, datë 25.03.2021 dhe Kontratën nr. 2721 rep., nr. 2067 kol., datë 09.07.2021 të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëria ka fituar të drejtën “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike “Blue 2” me kapacitet të instaluar 50 MW dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier”.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 107, datë 21.04.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 22.04.2026 dhe 23.04.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.05.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1099/4 prot., datë 24.04.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije dokumentacionin/informacionin e munguar të aplikimit.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1099/5 prot., datë 14.05.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar.
- Për fillimin e kësaj procedure, ERE ka njoftuar dhe MIE-n, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1099/3 prot., datë 24.04.2026. Nga ana e tyre nuk rezulton të ketë pasur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.
- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar. Po ashtu, shoqëria ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 296 datë 30.12.2024 për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI